



"AlbAudit" SH.P.K.

**Kosova Nevi Romani Partija
(KNRP)**

Raporti i Auditorit të Pavarur

Pasqyrat Financiare

31 Dhjetor 2022

Tetor 2023

P ë r m b a j t j a

Raporti i Auditorit të Pavarur.....	3
Informata të Përgjithshme mbi Subjektin Politik.....	5
Pasqyrat Financiare.....	6
Shpalosjet e Pasqyrave Financiare.....	8
Përfundimi.....	12



“AlbAudit” SH.P.K.

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Drejtimit të SP “Kosova Nevi Romani Partija” – Prizren

Opinion i përmbajtur

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të SP (Subjektit Politik) “**Kosova Nevi Romani Partija**” (më tutje referuar si “Subjekt Politik” ose KNRP), që përfshinë Pasqyrën e Pozitës Financiare më 31 Dhjetor 2022 dhe Pasqyra e Të Hyrave dhe Shpenzimeve, si dhe një përmbledhje të Politikave të Kontabilitetit dhe Shënimeve Shpjeguese të Pasqyrave Financiare.

- Ne përmbahemi të shprehim një opinion mbi raportet financiare të vitit 2022 të SP “Kosova Nevi Romani Partija”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për opinion, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për opinion të auditimit, nëse pasqyrat financiare paraqesin gjendjen e drejt dhe reale si dhe ne pajtim me ligjin Nr. 03/L-174 Mbi Financimin e Subjekteve Politike, të Ndryshuar dhe Plotësuar me ligjin Nr. 04/L-058 dhe ligjin Nr. 04/L-212 si dhe ligjin Nr. 08/L-122.

Bazat për opinion

- Pasqyrat financiare të SP, nuk kanë të raportuar aktivitetet financiar gjatë periudhës raportuese financiare që përfundon më 31 dhjetor 2022. Bazuar në këtë, ne nuk ishim në gjendje të shprehim një mendim nëse pasqyrat financiar janë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe ligjet e aplikuara në Republikën e Kosovës.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimit e bërë. Gjatë angazhimit tonë, ne ishim të pavarur nga Subjekti Politik dhe shoqëria në përputhje me kodin e etikës për profesionistët kontabël (kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë. Po ashtu ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit - Theksim i Çështjes

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojnë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.



“AlbAudit” SH.P.K.

Ne besojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Ne terheqim vemendjen lidhur me momentet e mëposhtme:

- Gjatë punës sonë ne kemi konstatuar se SP nuk posedon llogari bankare aktive në një nga Bankat Komerciale në Republikën e Kosovës siç kërkohet me me Nenin 4, të Ligjit nr. 03/L-174 – Për Financimin e Subjekteve Politike, nenin 3.3 të Ligjit nr. 04/L-212 – Për Plotësim dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174.

Përgjegjësia e drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjin Nr. 04/L-174 Mbi Financimin e Partive Politike, i Ndryshuar dhe Plotesuar me ligjin Nr. 04/L-058 dhe ligjin Nr. 04/L-212 si dhe ligjin Nr. 08/L-122. Për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të gabimit apo mashtrimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësitë e subjektit politik për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç se kur drejtimi synon ta likujdoj subjektin politik ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa më sipër. Të ngarkuarit me qeverisjen e Subjektit Politik, janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP.

Përgjegjësia e audituesit të pavarur

Objektivat tona gjatë auditimit janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshinë opinion tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikoj gjithmonë një anomali materiale kur ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose se bashku, pritet në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

“AlbAudit” SH.P.K.

Hajdar Hoxhaj, Auditor Ligjor

12 tetor 2023

1. Informata të Përgjithshme mbi Subjektin Politik

Emri i plotë i Subjektit Politik, është "Kosova Nevi Romani Partija" KNRP, regjistruar më 4/8/2014, më selin qendrorë në Rr. Uliqini, Nr. 85, Prizren.

Kryetari i SP për vitin raportues (2022) është zt. Jollxhi Shala.

Përfaqësuesi Financiar i SP është zt. Abdulla Ballabani.

Pasqyrat Financiare të SP janë përgaditur dhe prezantuar në pajtueshmëri me ligjin Nr. 04/L-174 Mbi Financimin e Partive Politike, i Ndryshuar dhe Plotësuar me ligjin Nr. 04/L-058 dhe ligjin Nr. 04/L-212 si dhe ligjin Nr. 08/L-122.

Bazua në ligjin Nr. 08/L-122 Për Plotësim dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 Për Financimin e Subjekteve Politike, të Ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-212, nenin 19, paragrafi 7 - Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e rezultateve paraprake të kontrollimit mund ta dorëzojë raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimin lidhur me çdo gabim të dukshëm ose lëshim të identifikuar nga auditorët.

Subjekti Politik, llogari bankare në ProCredit Bank e posedon të mbyllur nga dt. 08/01/2019.

2. Pasqyrat Financiare

Pasqyra e Pozitës Financiare Me 31 Dhjetor 2022			Akronimi: _____	
P	Pasuritë	Shënimi	31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro	31 dhjetor 2021 Shuma në Euro
P.1	Pasuritë afatgjata			
P.1.1	Toka, objektet dhe pajisjet	5		
P.1.2	Pasuritë e paprekshme			
P.1.3	Pasuritë tjera afatgjata			
	Gjithsej pasuritë afatgjata		0.00	0.00
P.2	Pasuritë afatshkurtra			
P.2.1	Llogaritë e arkëtueshme	6		
P.2.2	Parapagimet			
P.2.3	Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7		
P.2.4	Pasuritë tjera afatshkurtra			
	Gjithsej pasuritë afatshkurtra		0.00	0.00
	Gjithsej pasuritë (P.1+P.2)		0.00	0.00
E	Ekuiteti			
E.1	Fondet e akumuluar		0.00	0.00
E.2	Suficiti / (deficiti) i vitit		0.00	0.00
	Gjithsej Ekuiteti		0.00	0.00
D	Detyrimet			
D.1	Detyrimet afatgjata			
D.1.1	Huatë e pagueshme			
D.1.2	Të hyrat e shtyera			
	Gjithsej detyrimet agatgjata		0.00	0.00
D.2	Detyrimet afatshkurtra			
D.2.1	Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8		
D.2.2	Huatë e pagueshme			
D.2.3	Detyrimet tjera afatshkurtra	9		
	Gjithsej detyrimet afatshkurtra		0.00	0.00
	Gjithsej detyrimet (D.1+D.2)		0.00	0.00
	Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet (E+D)		0.00	0.00

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2022		Akronimi: _____		
		Viti që përfundon me 31 Dhjetor		
		Shënimi	2022	2021
H	Të hyrat			
H.1	Të hyrat nga buxheti			
H.2	Të hyrat nga anëtarësia			
H.3	Donacionet dhe kontributet në të holla	3		
H.4	Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4		
H.5	Të hyrat e fushatës			
H.6	Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera	5		
H.7	Të hyrat tjera			
	Gjithsej të hyrat për vitin		0.00	0.00
SH	Shpenzimet			
SH.1	Pagat dhe kompenzimet	2		
SH.2	Shpenzimet e transportit	2		
SH.3	Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2		
SH.4	Shpenzimet e fushatës	2		
SH.5	Blerja e mallrave	2		
SH.6	Shpenzimet e përgjithshme	2		
SH.7	Shpenzimet e ndryshme	2		
	Gjithsej shpenzimet për vitin		0.00	0.00
Suficiti (+) ose deficit (-) për vitin (H-SH)			0.00	0.00

3. Shpalosjet e Pasqyrave Financiare

Shënimi 2. Shpenzimet

Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2022

SH	Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
SH.1	Pagat dhe kompensimet			
	Pagat dhe kompensimet, neto			
	Kontributet pensionale të punëmarrësit			
	Kontributet pensionale të punëdhënësit			
	Tatimet në të ardhura personale			
	Beneficionet tjera			
	Gjithsej	0.00	0.00	0.00
SH.2	Shpenzimet e transportit			
	Automjetet motorike të huazuara			
	Karburantet			
	Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			
	Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			
	Çdo shpenzim tjetër i transportit			
	Gjithsej shpenzimet e transportit	0.00	0.00	0.00
SH.3	Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
	Lokali			
	Ushqimi			
	Aktivitete kulturore dhe rekreative			
	Radio dhe spotet televizive			
	Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta			
	Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave			
	Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	0.00	0.00	0.00
SH.4	Shpenzimet e fushatës			
	Shpenzimet e fushatës			
	Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
SH.5	Blerja e mallrave			
	Furnizimi i zyrës			
	Pajisjet të vogla			
	Gjithsej blerja e mallrave	0.00	0.00	0.00

SH.6	Shpenzimet e përgjithshme			
	Qiraja e lokalit të zyrës			
	Telefoni, interneti dhe posta			
	Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			
	Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë			
	Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime			
	Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	0.00	0.00	0.00
SH.7	Shpenzimet e ndryshme			
	Miëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			
	Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			
	Gjithsej shpenzimet e ndryshme	0.00	0.00	0.00
	Gjithsej shpenzimet (nga SH.1 në SH.7)	0.00	0.00	0.00

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla
 Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2022

Akronimi:

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				0.00	0.00	0.00

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime
 Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2022**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

**Shënimi 5. Toka, objektet dhe pajisjet
 Me 31 Dhjetor 2022**

Akronimi: _____

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					0.00
Objektet					0.00
Veturat					0.00
Pajisjet e zyrës					0.00
Pajisjet e teknologjisë informative					0.00
Pajisjet tjera					0.00
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet		0.00	0.00	0.00	0.00

**Shënime tjera
 Me 31 Dhjetor 2022**

Akronimi: _____

Shënimi 6. Llogaritë e arkëtueshme	Me 01 Janar 2022 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro
..... blerësi 1		
..... blerësi 2		
..... blerësi 3		
..... blerësi 4		
Llogari të arkëtueshme të tjera		
Gjithsej llogaritë e arkëtueshme	0.00	0.00

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Paraja në bankë		
Paraja në arkë		
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	0.00	0.00

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Shuma në Euro	Shuma në Euro
..... furnitori 1		
..... furnitori 2		
..... furnitori 3		
..... furnitori 4		
Llogari të pagueshme të tjera		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	0.00	0.00

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrimet tjera afatshkurtra		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	0.00	0.00

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro
Viti që përfundon me 31 Dhjetor 2022

Qëllimi i pagesës	Paguar ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro					0.00

4. Përfundim

Me kompetencë dhe siguri të arsyeshme mund të konstatojmë, nga pasqyrat financiare dhe shpalosjet e pasqyrave, shihet se ekziston një saktësi e mjaftueshme në regjistrime kontabël dhe evidenca. Nuk kemi arritur të vërejmë ndonjë gabim apo tendencë për ndonjë gabim material apo ndonjë mashtrim. Gjatë sigurimit të dokumentacionit nuk kemi hasur në ndonjë pengesë për ta bërë këtë. Auditimin e kemi planifikuar, dhe programin e auditimit e kemi realizuar sipas dinamikës së paraparë. Ne do të dëshironim të shprehim vlerësimin dhe falënderimin tonë për bashkëpunim dhe asistencë të ofruar nga personeli i kontaktuar i Subjektiut Politik.